



World Vision

Nr. 640 Prot. datë 06/12/2019

Nr. 01 Prot. datë 06/12/2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Numri i marrveshjes
Titulli i projektit

: _____
: “Mbështetje me shërbim psiko-social për fëmijë dhe të rritur me shenja të traumës në Bashkitë Lezhë, Kurbin, Kamzë dhe Durrës”

Organizata zbatuese
Periudha e buxhetit:
Mbështetja e WV (në natyrë)

: Urdhëri i Psikologut
: 24 Dhjetor 2019 – 30 Mars 2020
: _____

KJO MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI BËHET NGA DHE MIDIS:

World Vision Albania (më poshtë, e quajtur WVA), një organizatë ndërkombëtare joqeveritare, me regjistrim gjykatë 2544 më 09/09/1999, NIPT **J92127018B**, me zyrën e saj shqiptare të vendosur në Rr. “Skenderbej” Ndertesa “Gurten” kati 2 Tirane

E përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutive dhe Përfaqësuesi Ligjor i saj, Znj. Eljona Boce Elmazi
DHE

Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë, në vijim **Urdhri i Psikologut**, me adresë: Blv Gjergj Fishta, Nd 26, Kati 2, Ap 9, është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkët të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon veprimtaritë e marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikutbazuar në ligjin 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Presidentja **Znj. Valbona Treska**

Në bazë të bashkëpunimit ndërinstitucional mes WVA me UP, për të ofruar shërbime psiko-sociale, terapeutike si individuale ashtu dhe në grup nëpërmjet psikologëve të licensuar për fëmijë dhe të rritur të identifikuar me shenja të përballjes me traumën në Bashkitë Lezhë/ Shëngjin; Kurbin; Kamzë; Durrës.

NËPËRMJET KËSAJ, PALËT BIEN DAKORD PËR SA MË POSHTË:

1. Subjekti i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka të bëjë me bashkëpunimin për të zhvilluar aktivitetet e mesiperme, të cilet do të financohen bashkarisht nga WVA dhe do të zbatohet në partneritet mes WVA dhe UP.

2. Parimet e partneritetit

1. Ky partneritet bazohet në vizionet e përbashkëta të WVA-së që “Fëmijët dhe familjet e tyre në Shqipëri, sidomos, ata më vulnerabel, të përmiresojnë mirëqënien e tyre veçanërisht në aspektet psikologjike dhe emocionale” dhe vizionit të Urdhërit të Psikologut, që është në funksion të krijimit dhe funksionimit të një shërbimi cilësor psikosocial të rregulluar me dispozita ligjore për ofrimin e shërbimeve nga profesionistë të licencuar.
2. WVA dhe UP pranojnë se ky partneritet do të bazohet në parimet e zhvillimit në aspektet psikologjike dhe emocionale kryesisht të fëmijëve dhe familjarëve të tyre të afektuar nga pasojat e tërmetit që shkaktoi situatën e emergjencës në Shqipëri. Ata përkushtohen që të krijojnë vullnet të mirë, besim dhe mirëkuptim reciprok në çdo rast të mundshëm, si dhe të identifikojnë, dokumentojnë dhe zbatojnë praktika të mira partneriteti për të siguruar suksesin e projekteve të partneritetit.
3. WVA dhe UP bien dakord se, kur të planifikojnë ose zbatojnë aktivitete të një natyre psikosociale ose terapeutike të sigurojnë koordinim me organizata të tjera në nivel lokal të ndërhyrjeve të identifikuar duke maksimizuar kohën dhe burimet në dispozicion për të ofruar terapi individuale në group dhe jo duke u limituar në aktivitete të një natyre rekreative ose vetëm me bazë lojën.
4. WVA dhe UP bien dakord të punojnë në zonat e përcaktuara në këtë marrëveshje me burimet njerëzore të rekomanduara nga UP të cilët janë anëtarë të licencuar të UP. Këtu përfshihen psikologë të punësuar në një institucion shtetëror, të paguar nga organizatë ose agjensi tjetër ose që janë mbartës të statusit të nëpunësit civil.
5. Secila Palë do të ketë personalisht përgjegjësinë për t’u përputhur me legjislacionin ose rregullat në fuqi kur të kryejë punë dhe veprimtari të tjera nën këtë Marrëveshje dhe partneritet.
6. Secila Palë bie dakord që të mos paguajë, apo të premtojë të paguajë, apo të autorizojë pagesën e parave apo diçkaje me vlerë, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, për ndonjë person (qoftë ai zyrtar qeverie apo individ privat) me synim që të nxisë në mënyrë të paligjshme apo të papërshtatshme ndonjë zyrtar, parti politike, apo zyrtar partie politike, që të marrë ndonjë vendim prokurimi, apo të ndihmojë në mënyrë të paligjshme ose të papërshtatshme ndonjë vendim nga Palët për të përfituar ose për të siguruar punë, ose të marrë ndonjë veprim tjetër të favorshëm për ndonjërin nga Palët në lidhje me këtë marrëveshje dhe partneritet. Pala që nuk pajtohet me këtë klauzolë do të zhdëmtojë, do të mbrojë ose do të konsiderojë të pafajshme Palën tjetër nga dhe kundrejt çdo pretendimi, humbjeje, dëmtimi, përgjegjësie, shpenzimi, kostoje të çdo lloji natyre që del nga mosrespektimi i kësaj nga Pala në fjalë.

3. Përgjegjësitë e WVA nën këtë partneritet

1. T’i vërë në dispozicion UP burime në kohën e duhur sipas raporteve të ecursionit dhe parashikimeve të likuiditetit. **(nëse është e aplikueshme)**

2. Të ndërlihet rregullisht me UP dhe t'i sigurojë mbështetje kur kjo gjë kërkohet sipas mendimit të WVA-së, me qëllim që të sigurohet që po mbahen dokumentacione të mjaftueshme dhe që burimet po përdoren në përputhje me këtë marrëveshje.
3. Të vizitohet aktivitetet e UP me qëllim që të mbështesë projektin dhe të vlerësojë arritjet.
4. Të mbledhë, verifikojë dhe konsolidojë kërkesat e partnerit për mbështetje, plane aktivitetesh dhe raporte.
5. Të referojë raste të fëmijëve ose të familiarëve të tyre të zhvendosur në hotele, kampe dhe në zonat e tjera të afektuara nga emergjenca ku WVA zbaton programet e veta.
6. Të sigurojë trajnim për politiken e mbrojtjes së fëmijëve dhe protokollin e sjelljes që duhet të zbatohet të gjithë anëtarët e stafit të cilët do jenë përgjegjës për programin dhe angazhimin me fëmijët, para fillimit të aktiviteteve.
7. Të koordinojë/të marrë pjesë në takimet periodike të shqyrtimit të ecurisë me UP dhe palë të tjera të interesuara.
8. Të organizojë një seminar ndërgjegjësimi për t'ë njohur partnerin me Politikën e WVA-së për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe me kuadrin e përgjithshëm të mbrojtjes së fëmijëve.

9. Përgjegjësitë e përgjithshme të Urdhërit të Psikologut:

1. Të referojë pranë WVA kontakte të psikologëve të licencuar pranë UP që operojnë në zonat e afektuara nga emergjenca të cilët nuk janë psikologë të punësuar në një institucion shtetëror, të paguar nga organizatë ose agjensi tjetër ose që janë mbartës të statusit të nëpunësit civil.
2. Të informojë menjëherë WVA-në nëse nuk është në gjendje të zbatojë aktivitetet sipas marrëveshjes, me shpjegime për vonesat dhe planet alternative nëse lind nevoja të zëvendësohen psikologët e referuar nga urdhëri.
3. Të sigurojë pjesën e supervizimit dhe sigurimit të ofrimit të një shërbimi cilësor të ofruar nga profesionistët e referuar pranë WVA.
4. Të sigurojë mjete administrimi të ndryshme që lidhen me identifikimin dhe trajtimin e situatave individuale ose në terapistë e grupit në rastet kur psikologët do e kenë të nevojshme.
5. UP të sigurohet që individët e referuar do t'i përmbahet Politikës së WVA-së për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Të rriturve (SHTOJCA) të cilët do të firmosin individualisht dhe të pajtohen me përmbajtjen e këtij dokumenti.

5. Natyra e kontributit të WVA-së

WVA bie dakord të vendosë në dispozicion të UP burimet e mëposhtme për zbatimin e projektit.

1. Mbështetje financiare me ditë pune për psikologët e licencuar që do të ofrojnë shërbime terapeutike individuale, në grup sipas nevojave të identifikuara në terren.

6. Kushtet e kontributit

Në parim, WVA do të ndjekë të gjitha procedurat e brendshme të prokurimit dhe nuk do i transferojë fonde direkt UP-së.

7. Detyrimet

WVA nuk do të ketë detyrim për pretendime dëmshme me të cilat mund të përballet UP nga ana e një pale të tretë, ose për ndonjë dëm që i shkaktohet një pale të tretë si rezultat i aktivitetit të UP, sipas kësaj marrëveshjeje.

8. Raportimi

Pas fillimit të aktiviteteve të projektit, WVA do të bashkëpunojë me UP për hartimin e një databaze për të siguruar evidencat e duhura në lidhje me numrin e përfituesve, llojin e shërbimit të ofruar, orët e terapive të ofruara etj.

9. Administrimi

UP do të mbajë llogari të sakta dhe sistematike të çdo mbështetjeje të marrë nga WVA, duke përdorur një libër të përshtatshëm kontabël ose ndonjë sistem të ngjashëm, sipas aprovimit të WVA-së **(nëse është e aplikueshme)**

10. Publiciteti

Nëse ia kërkon WVA, UP do të bashkëpunojë në aktivitete publicitare. Nëse UP organizon ose përfshihet në aktivitete publiciteti të lidhura me këtë projekt, WVA duhet lajmëruar që më përpara. Çdo botim, material, etj., i prodhuar me këto financime duhet të mbajë logon e WVA-së.

UP do të bashkëpunojë me WVA për çështje publiciteti. UP do ta njoftojë WVA më parë kur organizon publicitete që lidhen me projektin e financuar dhe do të komunikojë kontributin e WVA në çdo deklaratë të mediave audio-vizive dhe sociale.

11. Kontrolli

Në lidhje me ecurinë dhe raportimin për projektin, edhe pas përfundimit të kontratës, WVA mund të hapë një kontroll në lidhje me burimet që ka siguruar WVA sipas kësaj marrëveshjeje. Me vendim të WVA-së, ky kontroll mund të kryhet nga përfaqësues të WVA-së dhe/ose palë të treta që do të caktohen nga WVA-ja dhe/ose persona të emëruar bashkërisht nga WVA-ja dhe nga UP. **(nëse është e aplikueshme)**

Në çdo kohë, UP do të sigurojë çdo bashkëpunim të mundshëm.

12. Audit

WVA ruan të drejtën të shqyrtojë gjithë të dhënat e të gjitha aseteve të siguruar me fonde të WVA-së, si dhe të kontraktojë një audit të pavarur të këtij projekti të zbatuar nga UP brenda tremujorit të parë të vitit vijues, me kostot e vetë WVA-së. **(nëse është e aplikueshme)**

13. Përfundimi

WVA do të ketë të drejtën e përfundimit të marrëveshjes nëse, sipas mendimit të WVA-së, UP ose punonjësit e urdhërit.
a) mund të konsiderohet se nuk është më në gjendje të zbatojë projektin siç tregohet në raportet monitoruese, në përputhje me marrëveshjen, ose se zbatimi i mëtejshëm i projektit nuk do të arrinte objektivat e synuar fillimisht.

b) dështon, pa shfajësim, të përmbushë detyrimet dhe, pasi është njoftuar me shkrim për t'i përmbushur këto detyrime, prapëseprapë dështon t'i përmbushë ose të sigurojë një shpjegim të kënaqshëm brenda 30 ditësh nga data e letrës.

c) falimenton, ose po mbyllet, aktiviteti i saj po administrohet nga gjykata, ka hyrë në ujdë me kreditorët, ka pezulluar aktivitetet e biznesit, është subjekt procedimesh në lidhje me këto çështje, ose ndodhet në një situatë analoge që del nga një procedurë e ngjashme, e siguruar nga legjislacioni ose rregullat kombëtare; (kjo klauzolë është e aplikueshme vetëm për organizata të regjistruara të shoqërisë civile)

d) është dënuar për shkelje në lidhje me sjelljen profesionale nga një gjykim, ose është fajtorë për shkelje të gabuar të sjelljes profesionale të provuar nëpërmjet mjetesh të justifikuar;

e) përfshihet në ndonjë veprim mashtrues ose korrupsion, ose përfshihet në një organizatë kriminale, ose në ndonjë veprimtari tjetër të paligjshme që është në dëm të interesave financiare të komuniteteve: kjo vlen edhe për punonjësit, partnerët, kontraktorët dhe punonjësit e UP;

f) ndryshon personalitet ligjor, përveçse nëse përpilohet një dokument shtesë që e dokumenton këtë fakt; (kjo klauzolë është e aplikueshme vetëm për organizata të regjistruara të shoqërisë civile)

g) bën pohime të rreme ose të paplota për të përfituar fondet e parashikuara në kontratë ose jep raporte që nuk pasqyrojnë realitetin.

h) shkel Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve (SHTOJCA), për të cilën është rënë dakord.

14. Data e fillimit dhe fundit të marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën që WVA merr nga UP një kopje të firmosur nga të dyja palët.

15. Transferimi i marrëveshjes

Marrëveshja dhe pagesat që lidhen me të nuk mund t'i transferohen, (nën)kontraktohen ose caktohen një pale të tretë në asnjë lloj mënyre pa marrë paraprakisht miratim me shkrim nga WVA-ja.

16. Dokumentet mbështetëse

Bashkëngjitjet e mëposhtme i shtohen kësaj marrëveshjeje dhe, në çdo faqe të tyre, janë vendosur inicialet e nënshkruesit të UP. Në rast mosmarrëveshjeje në lidhje me aktivitetet që duhen zbatuar dhe/ose buxhetin; rezultatet dhe ndryshime objektivash si dhe udhëzimet e raportimit, këto janë dokumentet të cilave do t'u referohemi:

- Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve (SHTOJCA D)

17. Konfidencialiteti

Asnjëra palë nuk do të zbulojë informacione pronësore ose konfidenciale të palës tjetër në lidhje me programin, me këtë marrëveshje, ose me biznesin apo me veprimet e palës tjetër pa miratimin paraprak me shkrim të palës në fjalë.

18. Ligjet e zbatueshme dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kjo marrëveshje u nënshtrohet ligjeve të Shqipërisë. Mosmarrëveshjet që, sipas mendimit të njëjës prej palëve, nuk janë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme, mund t'i kalohen gjykatës kompetente.

Për Urdhërin e Psikologut

Dr.Valbona TRESKA
Presidente



për World Vision Albania

